

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe alineja 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), si dhe në bazë të nenit 7 paragrafi 1, alineja 4 të Ligjit për Byronë e zhvillimit të arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimorë për lëndën *shkencat natyrore* për klasën e III të arsimit fillor nëntëvjeçarë.

Cambridge International Examination
Byroja e zhvillimit të arsimit

PROGRAMI MËSIMOR

SHKENCAT NATYRORE

për klasën e III

Arsim fillor nëntëvjeçar

Shkup, shkurt 2014

Hyrje

Programi mësimor i *shkencave natyrore* për klasën e tretë të arsimit fillor nëntëvjeçar është i marrë nga Qendra ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe është i adaptuar nga Byroja për zhvillimin e arsimit. Pëlqimi për programet mësimore të adaptuara është marrë nga ekspertët e Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore zhvillimore nga fusha e shkencave natyrore. Në te në mënyrë të detajuar përshkruhet çka nxënësi duhet të dijë ose çka nevojitet për të bërë çdo vit shkollor në arsimit fillor. Qëllimet mësimore sigurojnë strukturën e mësimdhënies dhe mësimxënies si dhe rekomandime për atë se cilët aftësi dhe njohuri të nxënësit mund të kontrollohen.

Programi mësimor i shkencave natyrore për arsim fillor është përfaqësuar në katër fusha përmbajtjesorë: hulumtim shkencor, biologji, kimi dhe fizikë. Hulumtimi shkencor përfshinë shqyrtim të ideve, vlerësim të dëshmive, planifikim të punës hulumtuese si dhe evidentim dhe analizë të të dhënave. Hulumtimin shkencorë e forcon biologjia, kimia dhe fizika të cilat nga ana tjetër janë të fokusuara në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesimin për arritje të diturive shkencore. Këtu, gjithashtu, janë përfshirë edhe fushat siç është ndërtimi i vetëdijes për ambientin jetësor dhe pjesërisht historia e shkencave natyrore. Korniza e programeve mësimore për shkencat natyrore për arsim fillor ofron edhe bazë solide mbi të cilën mund të sendërtohet arsimimi i mëtutjeshëm.

Programi mësimor duhet të realizohet me fond prej 2 orë në javë, gjegjësisht 72 orë në vit.

Pjesë të programit mësimor që kanë të bëjnë me vlerësimin, kushtet hapësinorë për realizimin e mësimit dhe normativi për kuadrin arsimor janë dhënë në përputhshmëri me nenin 25 alineja 5 të ligjit për arsim fillor.

Programi mësimor për klasën e III-të

1. Fushat dhe rezultatet e pritura

Hulumtim shkencor

Ide dhe dëshmi:

- mbledh dëshmi në situata të ndryshme që të përgjigjet në pyetje ose provojë idetë;

Planifikimi i punës hulumtuese:

- propozon ide, parashikon dhe diskuton për të njëjtat;
- me ndihmë, mendon për grumbullimin e dëshmive dhe planifikon prova.

Përfitimi dhe prezantimi i dëshmive:

- vështron dhe krahason objekte , qenie të gjalla dhe ngjarje;
- me ndihmën e pajisjeve të thjeshta bën matje dhe shënon vështrimet në mënyra të ndryshme.
- paraqet rezultate me vizatim, grafikun dhe tabelë.

Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjeve:

- nga rezultatet nxjerr përfundim dhe fillon të shfrytëzon dituri shkencore për sqarime;
- gjeneralizon dhe fillon të identifikon modele të thjeshta në vet rezultatet .

Biologji

Bimët:

- din se bimët kanë rrënjë, gjethe, trung dhe lule;
- duke vështruar sqaron se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten;
- din se bimët, ujin e marrin përmes rrënjës, dhe atë e transmeton përmes trungut ;
- din se bimëve ju duhen rrënjë, gjethe dhe trung të shëndosh që të rriten në mënyrë të rregullt;
- din se temperatura ndikon në rritjen e bimëve.

Njerëz dhe kafshë:

- din për proceset jetësore që janë të përbashkëta për njerëzit dhe kafshët përfshi të ushqyerit (uji dhe ushqimi), lëvizja, rritja dhe riprodhim;
- përshkruan dallimet në mes gjalla dhe jo gjallesave duke shfrytëzuar diturit për proceset jetësore;
- hulumton se si ushtrimet fizike dhe ushqimi adekuat i llojllojshëm është i nevojshëm për mirëmbajtjen e shëndetit;
- din se ndonjë ushqim mund në mënyrë të dëmshme të ndikojë në shëndet, p.sh., ushqimi shumë i ëmbël apo i yndyrshëm,;
- i hulumton shqisat njerëzore dhe mënyrën se si ato i përdorim për të mësuar për botën;
- klasifikon gjallesat në grupe, duke shfrytëzuar karakteristikat e thjeshta dhe i sqaron shkaqet për grupim.

Kimi

Vetitë e materialeve:

- din se çdo material ka veti specifike, si p.sh., fortësi, butësi, shkëlqim;
- klasifikon materialet sipas vetive të tyre;
- hulumton se si disa materiale kanë veti magnetike, por edhe shumë materiale tjera të cilat nuk i posedojnë këto veti;
- diskuton, pse materialet përzgjedhjen për qëllime të caktuara në bazë të vetive të tyre.

Fizikë

Forcat dhe lëvizja :

- din se forcat shtytëse dhe forcat tërheqëse janë shembuj të forcës dhe se të njëjtat mund të maten me instrument;
- hulumton se forcat mund të nxisin lëvizje të objekteve ose ta ndërpresin lëvizjen e tyre;
- hulumton se si forcat mund të ndryshojnë formën e objekteve.
- hulumton se si forcat, veçanërisht forcat e fërkimit, mund të nxisin lëvizje të shpejtuar ose të ngadalësuar të objekteve ose ndryshim të kahes apo drejtimin e lëvizjes.

2. Qëllimet konkrete, aktivitetet dhe mjetet për punë

Qëllimet në programin mësimor për shkencat natyrore janë të grupuara në gjashtë njësi tematike sipas një renditje të caktuar, por realizuesi mund lirisht t'i realizoj me nxënësit ashtu si diktojnë kushtet lokale, mjetet dhe materialet për mësim. Qëllimet e hulumtimit shkencor përsëriten, paraqiten në çdo temë dhe si të tilla janë theksuar në fillim të çdo teme. Në programin mësimor për klasën e tretë ka gjashtë tema të cilat mundësojnë të mësuarit gradual të përmbajtjeve mësimore nga biologjia, kimia dhe fizika. Aktivitetet dhe resurset (mjetet dhe materialet) janë propozuar sipas qëllimeve të dhëna që të ofrojnë metoda dhe aktivitete të mundshme për realizim të suksesshëm të programit.

Proceset jetësore	Bimë që lulëzojnë	Shqisat
Materiale	Hyrje në forca	Mirëmbajtja e shëndetit

Proceset jetësore

Kjo temë është e orientuar ka proceset themelore jetësore të përbashkëta për shtazë dhe bimë.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- vështrim dhe krahasim të qenieve të gjalla;
- shënim i vështrimeve;
- bërja e gjeneralisimëve.

Qëllimet mësimore	Nocione
<p>Ide dhe dëshmi: - mbledh dëshmi në situata të ndryshme për të dhënë përgjigje në pyetje ose të verifikoj idetë.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese - propozon ide, parashikon dhe diskuton për to. - mendon për grumbullimin e dëshmive dhe planifikon realizim të provave me aktivitete konkrete në kushte të njëjta.</p> <p>Përfitimi dhe paraqitja e dëshmive: - vëzhgon dhe krahason objekte, qenie të gjalla dhe ngjarje; - me ndihmën pajisjeve të rëndomta bën matje dhe i shënon vështrimet në forma të ndryshme; - paraqet rezultate me vizatim, gafikon dhe tabelë.</p> <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjeve: - nga rezultatet nxjerr përfundim dhe fillon të shfrytëzon dituri shkencore për sqarime; - gjeneralizon dhe fillon të identifikojë modele të thjeshta nga vet rezultatet.</p>	<p>Gjallë Jo e gjallë Lëviz Frymon Ushqim Riprodhim Ritet Ushqehet Ujë Njeri Shtazë Ajër</p> <p>Hulumtim shkencor: - përzgjedh; - grupon; - emëron; - përshkruan; - hulumton; - kontrollon;</p> <p>Shqisa Shije Prekje Shikon Dëgjon Aromë Farëra Lule Bimë Dritë Errësirë Shpjegon Shikon Flet Matën Krahason</p>

Qëllimet mësimore	Aktivitetet	Mjetet dhe materialet	Komente
<p>Grupon qenie të gjalla duke shfrytëzuar karakteristikat elementare për të sqaruar grupimin e tyre.</p>	<p>Identifikoni çka mund të bëjnë qeniet e gjalla – të lëvizin, rriten, riprodhohen, frymojnë, ushqehen, përdorin shqisat.</p> <p>Aktivitete të llojllojshme për shqisat: Teste për shije/aromë. „strajca për prekje” , lojë me sy të mbyllur, aktivitete për dëgjim/ identifikimi i zërave,</p> <p>Realizimi i aktiviteteve në grupe</p>	<p>Fotografi Hullahop/ litar „Strajca për prekje” Thjerrëz.</p>	
<p>Përshkruan dallimet në mes gjallesave dhe jo gjallesave duke shfrytëzuar njohurit e fituara mbi proceset jetësore.</p>	<p>Përsëritje për gjallë dhe jo e gjallë.</p> <p>Dallon në mes të gjallës dhe jo të gjallës.</p> <p>Hulumtim për mënyrat e ndryshme të lëvizjeve. Hulumtim se si marrim frymë .</p>	<p>Burime sekondare- interne, libri, CD.</p> <p>Pasqyrë</p>	
<p>Kupton proceset jetësore që janë të përbashkëta për njerëz dhe shtazët duke përfshi të ushqyerit(uji dhe ushqimi),lëvizjen, rritjen dhe riprodhim.</p>	<p>Konstatim çka është e nevojshme që të mbetemi gjallë.</p> <p>Diskutim edhe për nevojat e gjallesave.</p> <p>Vizitë e tregut lokal dhe vështrimi mbi ushqimet e pranishme.</p> <p>Përcaktimi i ndryshimeve nga momenti i lindjes deri tani.</p> <p>Diskutim për ndryshimet tjera fizike tek njeriu, p.sh., rritja.</p>	<p>Fotografi</p>	

<p>Kupton se bimët kanë nevojë për rrënjë , gjethe dhe trung të shëndosha që të rriten më mirë.</p>	<p>Përsëritje çka u nevojitet bimëve që të rriten më mirë. Matja e bimëve në rritje për periudhë disa javësh. Mbjellja e farës dhe vështrimi i rritjes së luleve.</p>	<p>Shembuj të bimëve për krahasim (e shëndoshtë, të pa ujitura, të ruajtura në errësirë)</p>	
---	--	--	--

Materialet

Këtu nxënësit i zgjerojnë diturit e tyre për lloje të ndryshme të materialeve të cilat i përdorim dhe vetit e tyre karakteristike. Zhvillohen ide për atë se pse materialet përzgjedhjen për përdorime specifike.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- grumbullimin e dëshmive për t'u përgjigjur në pyetje ose vërtetim të ideve;
- propozim idesh, parashtrim të parashikimeve dhe diskutim;
- shkathtësitë e të vështruarit;
- matje duke shfrytëzuar pajisje të rëndomta dhe të shënuarit e asaj që është vështruar;
- prezantimin e rezultateve;
- nxjerrjen e përfundimeve me sqarime shkencore.

Qëllimet mësimore	Nocionet	
<p>Ide dhe dëshmi: -grumbullon dëshmi në situata të ndryshme që të përgjigjet në pyetje ose të provon idetë.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese: - propozon ide ,parashikon dhe diskuton për to; - mendon për grumbullimin e dëshmive dhe planifikon realizim të provave me aktivitete konkrete në kushte të njëjta.</p> <p>Përfitimi dhe prezantimi i dëshmive: - vështron dhe krahason objekte, krijesa të gjalla dhe ngjarje ; - me ndihmën e pajisjeve të rëndomta bën matje dhe i shënon vështrimet në mënyra të ndryshme; - paraqet rezultate me vizatim, gafikon dhe tabelë.</p> <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjeve: - nga rezultatet nxjerr përfundim dhe fillon të shfrytëzon dituritë shkencore për sqarime; - gjeneralizon dhe fillon të identifikon modele të thjeshta në vet rezultatet .</p>	<p>Material Objekt Fortë Butë Shkëlqim Vrazhdë Lëmuar</p> <p>Hulumtim shkencor: -parashikon; -kontrollon; -shënon; -merr vendim; -refuzon; -grupon;</p>	<p>Magnet Magnetik Jomagnetik Tërheqës/Tërheq Thithës Rezistues ndaj ujit</p>

Qëllimet mësimore	Aktivitetet	Mjetet dhe materialet	Koment
Din se çdo material ka veti specifike(p.sh. fortësi, butësi, shkëlqim)	Hulumtimi i materialeve shkollore. Lojë për zbulimin e materialeve.	Shembuj të materialeve/ objekteve të bëra nga ata. Fleta për shënime.	Filloni me përdorimin e emrave të materialeve të njohura.
Hulumton se disa materiale janë magnetik, kurse shumica prej tyre nuk janë të tillë..	Nga koleksioni i materialeve parashikoni kush do të jenë magnetik. Si do të zbulojnë? Planifikoni hulumtim. Gruponi rezultatet në materiale magnetike dhe jo magnetike.		
Diskutoni për se materialet janë përzgjedhur për qëllime specifike për shkak të vetive të tyre.	Përmirësimi i objekteve-hulumtues të ri. Përzgjidhni materiale alternative për objekte të njohura dhe këmbeni ide njëri me tjetrin ! Kontrolloni: Për shembull: Cila pecetë thith më tepër? Cila dysheme është më e mirë për të mbuluar një hapësirë të caktuar? Cili material është më mirë për ndonjë veshje të caktuar?	Objekte të përditshme. Materiale/ objekte për hulumtim.	Vlerësim: Prezantoni një objekt të njohur të punuar nga materiale të reja ose të ndryshme. Si do të testoheshin ata nëse përpunohen më së miri?
Mund të klasifikon materiale sipas	Loja për klasifikim-janë dhënë	Kuti/ enë për klasifikim.	

vetive të tyre.	kritere specifike, p.sh., rezistues ndaj ujit, përthithja etj. Bëni paraqitje të materialeve për klasën..		
-----------------	--	--	--

Bimët që lulëzojnë

Në këtë temë nxënësit do të zbulojnë se çka u nevojitet bimëve që të rriten mirë dhe pse është me rëndësi rritja e tyre.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- të menduarit se cilat dëshmi duhet të grumbullohen;
- bërjen e matjeve me kujdes;
- të menduarit se sa janë të mira dëshmitë;
- shfrytëzimin e rezultateve për të nxjerr përfundime;

Qëllimet mësimore	Nocone	
<p>Ide dhe dëshmi: -grumbullon dëshmi në situata të ndryshme që të përgjigjet në pyetje ose të teston idetë.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese : - propozon ide, parashikon dhe diskuton për ato; - mendon për mbledhjen e dëshmive dhe planifikon realizim konkret të provave në kushte të njëjta;.</p> <p>Përfitimi dhe të shfaqurit e dëshmive: - vështron dhe krahason objekte, krijesa të gjalla dhe ngjarje; - me ndihmën e pajisjeve të rëndomta bën matje dhe në mënyra të ndryshme i shënon vështrimet ; - tregon rezultatet me vizatime, grafikone dhe tabela;</p> <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjeve: - nga rezultatet nxjerr përfundime dhe fillon të shfrytëzon diturit shkencore për sqarime; - gjeneralizon dhe fillon të bën identifikimin e modeleve të thjeshta në vet rezultatet;</p>	<p>Bimë Rrënja Gjeth/gjethet Trung Lule Ujë Dritë Ritet</p>	<p>Errësiirë Komposto (Përzierje plehrash) Shëndosh Sëmur Vyshkur Efekt Temperaturë</p> <p>Hulumtim shkencor: -vështron; -mat; -sqaron ; -diskuton; -kontrollon; -vizaton; -identifikon;</p>

Qëllimet mësimore	Aktivitete	Mjete dhe materiale	Koment
Din se bimët kanë rrënjë, gjethe, trung dhe lule.	Përsëritni dituritë e nxënësve për pjesët e bimëve.. Lloje të ndryshme të gjetheve-vëzhgoni, bëni matjen dhe krahasoni.	Paraqitje/ postera Lloje të ndryshme të bimëve	Bimët nuk e marrin ushqimin nga rrënjët e tyre.
Sqaron të vështruarit se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të mund të rriten.	Vështro rritjen e bimës në errësi ose kur janë të mbuluara. Si mundet ta ringjallim bimën?	Lloje të ndryshme të bimëve.	
Kupton se uji kalon nëpër rrënjë dhe transmetohet nëpërmjet trungut .	Shqyrtoni bimë të mbjellë në saksi dhe përsëri rimbjellni. Diskutohet pse kjo është mirë për bimët. Vendosja e trungut në ujë të ngjyrosur dhe vëzhgimi i transmetimit të ujit nëpërmjet trungut p.sh., karafil, selino, etj. Kontrollim: a do të rritet bima më shpejt nëse i jepet më tepër ujë?	Bimë të mbjellë në saksi. Lulet.	Zgjerimi i të menduarit te nxënësit për faktin se rrënjët do të kenë hapësirë më të madhe, por gjithashtu do të kanë nevojë për ujitje të shtuar.
Kupton se bimët kanë nevojë për rrënjë, gjethe dhe trung të shëndoshë që të rriten mirë.	Njihni nëpër mjet ilustrimeve me bimë që kanë pjesë të ndryshme që duhet të funksionojnë në mënyrë adekuate që bima të rritet mirë. Vizato diagrame krahasuese të bimëve të shëndosha/ sëmurura.	Bimë të freskëta dhe të vyshkura. Burime sekondare-internet,	

	<p>Identifikoni rrënjë/trung/gjethet e bimëve të ndryshme.</p> <p>Diskutoni për drunjtë dhe rrënjët e tyre, trungun dhe gjethet.</p>	libër, CD.	
<p>Kupton se rritja e bimëve varet nga temperatura.</p>	<p>Bërja e eksperimenteve për të zbuluar ndikimin e temperaturës në rritjen e bimës- hulumtim i tërë klasës.</p>	<p>Termometër.</p> <p>Kopshti i qelqtë.</p>	

Inkuadrimi i forcave

Kjo temë bazohet në diturit e mëparshme për mbi forcat dhe si ata mund të ndikojnë në lëvizjen dhe në formën e objekteve.

Nxënësit do të zbulojnë se forcat mund të maten duke shfrytëzuar matës të forcës si dhe mund të krahasohen.

Ata njihen me tërheqje dhe refuzime magnetike .

Fërkimi inkuadrohet si forcë e cila ekziston ndërmjet objekteve që lëvizin mbi sipërfaqe të forta dhe të cilat i kundërvihen lëvizjes.

Janë inkuadruar rezistenca e ajrit dhe rezistenca e ujit, ata janë forca që i kundërvihen lëvizjes së objekteve në ajër dhe ujë.

Mësojnë se këta forca kanë drejtim dhe kahe dhe mund të ndryshohen për nga madhësia.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- grumbullimin e dëshmive;
- testimin e ideve/parashikime të bazuara në dituri shkencor dhe në të kuptuarit;
- propozim të pyetjeve për kontroll, bërja e parashikimeve dhe shkëmbim i të njëjtave:
- përgatitje të testit dhe si të grumbullohen dëshmi të mjaftueshme;
- përzgjedhje të aparateve dhe marrja e vendim se çka do të matim;
- bërja e vështrimeve relevante ;
- matje të forcës dhe gjatësisë;
- të menduarit për nevojën për rimatje;
- paraqitja e rezultateve në tabelë;
- sqarime se çka tregojnë dëshmitë dhe bisedë për atë se dëshmitë vallë i mbështesin parashikimet.

Qëllimet mësimore	Nocione	
<p>Ide dhe dëshmi: - grumbullon dëshmi në situata të ndryshme që të përgjigjet në pyetje ose të teston idetë .</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese - propozon ide, parashikon dhe diskuton për to. - mendon për grumbullimin e dëshmive dhe planifikon realizim të provave me aktivitete konkrete në kushte të njëjta.</p> <p>Përfitimi dhe prezantimi i dëshmive: - vëzhgon dhe krahason objekte, krijesa të gjalla dhe ngjarje; - me ndihmën pajisjeve të rëndomta matën dhe i shënon vështrimet në forma të ndryshme; - paraqet rezultate me vizatim, gafikon dhe tabelë.</p> <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjeve: - nga rezultatet nxjerr përfundim dhe fillon të shfrytëzon dituri shkencore për sqarime; -gjeneralizon dhe fillon të identifikon modele të thjeshta nga vet rezultatet.</p>	<p>Shtyp Tërheq Forca Matësi i forcës Njutën Drejtimit Kahe Pesha</p> <p>Hulumtim shkencor: -mat ; -diskuton; -hulumton; -krahason; -provon; -parashikon; -mbledh dëshmi;</p>	<p>Fillon Ndalet Ngadalëson Shpejton Fërkim Bëj shtypje</p> <p>-planifikon testim; -tregon rezultate; -shënon; -vizaton; -tabela; - konkluzë; -model.</p>

Qëllimet mësimore	Aktivitete	Mjete dhe materiale	Koment
<p>Kupton forcat shtytëse dhe ato tërheqëse.</p> <p>Kupton se forca mund të matet me matës të forcës.</p>	<p>Diskutoni për forca tjera.</p> <p>Si mund të themi se në çfarë drejtimi vepron forca?</p> <p>Njihni nxënësit me matësit e forcës. Hulumtoni se si ata funksionojnë. Matni disa forca në njutën (N).</p>	<p>Matës i forcës.</p>	<p>Krahasoni peshoret në vetëshërbime të cilat bëjnë matjen e masës në (kg), por potenconi se forca dhe masa maten me njuton.</p>
<p>Hulumton se si forcat mund ta ndryshojnë formën e objekteve.</p>	<p>Hulumtoni se si të bëhen forma të ndryshme me materiale të ndryshëm.</p> <p>Vështroni aktivitetet dhe përshkruani si shtytje apo tërheqje.</p>	<p>Materiale të buta për modelim.</p> <p>Llastik.</p>	
<p>Hulumton se si forcat mund t'i lëvizin ose t'i ndërpresin lëvizjet e objekteve.</p>	<p>Luani me automobil fëmijësh- hulumtoni çka e ndalon, ngadalëson ose e përshpejton.</p>	<p>Lojëra këmishë automobil, Parmak (barrierë) Shembuj të materialeve të ndryshme për sipërfaqen p.sh. e lëmuar, e vrazhdë, shkëlqyese etj.</p>	<p>Ndërlidhuni me punën e edukatës fizike, me hedhjen e topave të butë ose jastëkut- i shpejtë/ i ngadalshëm ndërrimi i drejtimit.</p>
<p>Hulumton se si forcat, duke përfshi edhe fërkimin, mund të bëjnë lëvizje më të shpejtë ose më të ngadalshme të objekteve apo ta ndryshojnë drejtimin e tyre.</p>	<p>Bisedoni për situata të përditshmërisë ku fërkimi do të mund të ju jetë në ndihmë: frenat e biçikletës, gjoni i këpucëve të juaja ose pengesat në vendet për rrëshqitje.</p> <p>Planifikoni hulumtim, për shembull: cilat atlete (këpucë sportive) do të bëjnë më tepër rezistencë?</p>	<p>Biçikletë- të tregohet se si punojnë frenat.</p> <p>DVD me rrëshqitje artistike.</p>	

Shqisat

Kjo temë u mundëson nxënësve të kuptojnë rëndësinë e shqisave të tyre.

Ata hulumtojnë aspekte duke i shfrytëzuar çdo shqisë në veçanti.

Kuptojnë pse disa shqisa janë të rëndësishme në jetën tonë të përditshme.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- grumbullimin e dëshmive në kontekste të ndryshme;
- testimi i ideve/parashikimeve të bazuara në dituri shkencore dhe të kuptuarit;
- sugjerim për pyetje të cilat mund të verifikohen dhe mbarështim të parashikimeve, bisedë për të njëjtat;
- sigurimi i kushteve të njëjta për aktivitete ose planifikime se si të grumbullohen dëshmi të mjaftueshme;
- përzgjedhje të aparaturave dhe marrja e vendimit se çka do të matim;
- bërja e vështirimeve relevante dhe krahasime ;
- prezantimi i rezultateve me vizatime, grafikun dhe tabelat;
- sqarime çka tregojnë dëshmitë dhe bisedë për atë se a i mbështetin parashikimet;
- ndërlidhja e dëshmive me dituri shkencore dhe kuptim.

Qëllimet mësimore	Nocionet	
<p>Ide dhe dëshmi -grumbullon dëshmi në situata të ndryshme për tu përgjigjur në pyetje ose për të testuar ide.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese: -proponon ide, parashikon dhe diskuton për to; -mendon për grumbullimin e dëshmive dhe planifikon realizimin e përpjekjes konkrete në kushte të njëjta.</p> <p>Përfitimi dhe prezantimi i dëshmive: -vështron dhe krahason objekte, qenie të gjalla dhe ngjarje; -me ndihmën e pajisjeve të thjeshta bën matje dhe i shënon vështrimet në mënyra të ndryshme; -prezanton rezultate me vizatime, grafikone dhe tabela.</p> <p>Vështrimi i dëshmive dhe qasjeve: -nxjerr përfundime nga rezultatet dhe fillon të përdorë dituri shkencore për sqarim; -gjeneralizon dhe fillon të identifikojë modele të thjeshta në vet rezultatet.</p>	<p>Shqisat Prekje Shije Aromë. Ndjenjë Shikon/vëren Sy Gjurmë nga gishtat Gjuhë Hundë Vesh Natyrale Jo natyrale Ushqim Materiale</p> <p>Hulumtim shkencor: -hulumton; -identifikon; -pyet; -grupon, krijon skica</p>	<p>Rritet Energji Proteina Vajra Sheqerna Qumështor Pemë Perime Mish Peshk Të ushqyerit Alergji Parfum Iluzion optik Dëgjon</p> <p>-diskuton -mendon; -bën; -krahason; -teston. grupon.</p>

Qëllimet mësimore	Aktivitetet	Mjete dhe materiale	Komente
<p>Hulumton shqisat njerëzore dhe mënyrat e përdorimit të tyre për ta njohur botën.</p> <p>Prekje</p>	<p>Luani lojën për identifikimin e objekteve vetëm me prekje dhe me parashtrimin e pyetjeve.</p> <p>Marrja e gjurmëve nga gishtërinjtë-vizita e personit nga policia lokale.</p> <p>Bërja e modeleve nga gjurmët prej gishtave me laps kimik/ngjyrë dhe vështrimi me llup.</p>	<p>Mbyllja e syve</p> <p>Zgjedhja e materialeve natyrore/artificial.</p> <p>“ Strajca për prekje”</p>	<p>Gjithmonë siguroni pëlqimin nga fëmijët me rastin kur ia mbyllni sytë.</p> <p>Jeni të vetëdijshëm për nevojat e fëmijëve me shikim të dëmtuar.</p> <p>Ndoshta është e nevojshme të merret pëlqim nga prindërit për marrjen e gjurmëve nga gishtërinjtë nga ana e policisë.</p>

<p>Shija</p>	<p>Vizitë e tregut lokal ushqimor ose ftojeni distributorin lokal për ushqim për të realizuar diskutim me nxënësit.</p> <p>Kategorizoni llojet e ndryshme të ushqimit</p> <p>Kolazhe- ushqim për rritje, energji etj.</p> <p>Aktivitete për shijimin e llojeve të reja të ushqimeve/ të pazakonta .</p> <p>Skica e gjuhës- fusha të shijeve. Si i shijojmë sendet?</p>	<p>Përmbledhje e produkteve ushqimore të vërteta ose prej plastike për grupim , diskutim dhe krahasim.</p>	<p>Duhet të jeni të vetëdijshme për alergjinë ndaj ushqimeve tek fëmijët.</p>
---------------------	--	--	---

Qëllimet mësimore	Aktivitete	Mjete dhe materiale	Komente
Aroma	<p>Diskutoni për aromat e këndshme dhe kujtimet të cilat i zgjojnë ato psh. pjekja e bukës, parfumi.</p> <p>Lexoni ndonjë tregim i cili i dedikohet aromave të këndshme.</p> <p>Mendoni për aromat e pakëndshme, bukë e thartuar, qumësht i thartuar. Ato na mbrojnë nga konsumimi i ushqimit i cili mund të jetë i prishur.</p> <p>Bëni pije aromatike!</p> <p>Përpiquni të hani portokall ose diçka ngjashëm, derisa e mbani të mbyllur hundën e juaj. Cila është dallimi?</p> <p>Si na ndihmon aroma?</p>		
Të pamurit (shikimi)	<p>Përpiquni të lexoni me njërin sy të mbyllur.</p> <p>Iluzione optike- si ata na mashtrojnë?</p>	Grafikon për testim të syrit	Kushtoni vëmendje nevojave të fëmijëve me shikim të dëmtuar dhe atyre të cilët mbajnë syza.

	<p>Testimi i syrit.</p> <p>Shkëmbeni përvojat e fëmijëve të cilët mbajnë syza.</p> <p>Vizita në kinema- shikim i filmit.</p> <p>Pse kemi nevojë për dy sy?</p>	nga optiku.	
Dëgjimi	<p>Loja për dëgjim- zëra në natyrë.</p> <p>Loja me ngjitje</p> <p>Kuisi për zëra.</p> <p>Hulumtim: Vallë me dy veshë dëgjohet më mirë se sa me një vesh?</p>	<p>Lista për shënime.</p> <p>Hapësirë e madhe shembull sallë shkollore.</p> <p>Vështrimi i zërave të ndryshëm të njohur.</p>	

Mirëmbajtja e shëndetit

Kjo temë u ndihmon nxënësve të zbulojnë shumë gjëra të cilat iu duhen t'i dinë për të qenë të shëndetshëm.

Ata do të mësojnë për zemrën dhe për atë se si ushtrimet fizike ndikojnë ndaj rrahjes së zemrës.

Ata e ndërlihdin këtë me atë që tani më e dinë për lëvizje dhe ushtrime.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- grumbullimi i dëshmimeve për kontekste të ndryshme për tu përgjigjur në pyetje ose ide për test;
- propozimi i ideve, parashtrimi i parashikimeve dhe diskutimit;
- vëzhgimi dhe krahasimi i qenieve të gjalla;
- shënimi i vështirimeve në mënyra të ndryshme.

Qëllimi mësimor	Nocione	
<p>Ide dhe dëshmi -grumbullon dëshmi në situatë të ndryshme për tu përgjigjur në pyetje ose të teston ide.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese -propozon ide, parashikon dhe diskuton për to; -mendon për grumbullimin e dëshmimeve dhe planifikon realizim të provave konkrete në kushte të njëjta.</p> <p>Përfitimi dhe prezantimi i dëshmimeve: -vështron dhe krahason objekte, qenie të gjalla dhe ngjarje; - me ndihmën e pajisjeve të thjeshta bën matjen dhe shënon vëzhgimet në mënyra të ndryshme; - prezanton rezultate me vizatime, grafikone dhe tabela.</p>	<p>Procese jetësore Njeri Gjallesë Të ushqyerit Ujë Ushqim Lëvizje Rritje</p> <p>Hulumtim shkencor: -krahason; -pyet; -krijon; -hulumton; -kontrollon;</p>	<p>Riprodhon Gjallëri Jo gjallëri Ushtrim Të ushqyerit Shëndetshëm Ushqim</p> <p>-analizon; -vëzhgon; -mendon;</p>

<p>Vështrimi i dëshmive dhe qasjet: -nxjerr përfundime nga rezultatet dhe fillon të përdor njohuri shkencore për sqarim; -gjeneralizon dhe fillon të identifikojë modele të thjeshta në vetë rezultatet.</p>	<p>-diskuton; -grumbullimi i dëshmive.</p>	
---	--	--

Qëllimet mësimore	Aktivitete	Mjete dhe materiale	Komente
Përsërit për proceset jetësore të përbashkëta për njerëzit dhe shtazët duke e përfshirë edhe të ushqyerit(ujin dhe ushqimi), lëvizjen, rritjen dhe riprodhimin, rikrijimin.	Përsëritja për atë se çka është e nevojshme për të mbetur të gjallë. Shikoni një video film për fëmijë nga pjesë të ndryshme të botës të cilët pësojnë nga mungesa e ushqimit ose ujit adekuat. Mendoni për mënyrat me të cilat do të mund t'i ndihmojmë.	Internet/libra/CD. Informata për organizata bamirës.	
Hulumton ushtrime dhe ushqime të llojllojshme të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen e shëndetit.	Prezantoni tregime nga historia e disa njerëzve të cilët kanë pasur ushqim joadekuat (paraqitja e rakitit, skorbutit etj.) Vizitë e ndonjë personi medicinal i cili do të flasë për ushqim të shëndetshëm / mënyrë të shëndoshë të jetesës. Analizoni ushqimin që e konsumojnë nxënësit në shkollë. Paramendoni shujtë të shëndetshme për një sportist ose njeri i cili shërohet pas ndonjë sëmundjeje.	Burime historike Fllaerë me informata për ushqim të shëndetshëm. Meny ditore/javore	
Kupton se ndonjë ushqim mund të jetë i dëmshëm për shëndetin, për shembull ushqimi shumë i	Ushqim ditorë- analizë	Udhëhiqni ditarë ditorë për ushqimin e juaj para se të fillojë kjo orë.	

<p>ëmbël apo i yndyrshëm.</p>	<p>Vendosni një dhëmb ose asht të pulës në një lëng të gazuar gjatë tërë natës.</p> <p>Shikoni fotografi nga gjingivit/ prishja e dhëmbëve.</p> <p>Gjeni informacione për sëmundje të zemrës- bëni flaerë/broshura për tua dhënë më të moshuarve.</p>	<p>Burime sekondare- Libra/ interneti /CD.</p> <p>Flaerë me informacion për shëndetin.</p>	
-------------------------------	---	--	--

3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

KONTROLLIMI DHE VLERËSIMI DIAGNOSTIFIKUES

Në fillim të vitit shkollor mësime mësuesi bën kontrollimin dhe vlerësimin diagnostikues me qëllim që të njohë gjendjen në funksion të planifikimit kualitativ dhe realizimit të aktiviteteve të ardhshme. Fitohen njohuri lidhur me njohuritë paraprake në kuptimin më të gjerë të fjalës, aspektet sociale të zhvillimit, zhvillimi emocional dhe zhvillimi fizik.

VLERËSIMI FORMATIV – Gjatë mësimit të lëndës shkencat natyrore në klasën e tretë sugjerohet përcjellja formative e cila përfshin përpunimin dhe udhëheqjen e përmbledhjes së dëshmive të nxënësve e cila përfshin:

- mbledhjen e treguesve për secilin nxënës në veçanti;
- lista evoluimi rrjedhëse (formative) të përgatitura paraprakisht për secilin nxënës veç e veç të cilat plotësohen pas aktiviteteve konkrete të tyre dhe e cila është specifike (pozitive ose negative ose studim rasti në të cilin mësuesi e shënon gjendjen faktike.
- instrumente që kanë të bëjnë me secilën fushë programore veç e veç dhe në të cilat mësuesi vendos **të dhëna mbi të arriturat e nxënësve në raport me të gjitha aspektet zhvillimore** të cilat nxiten me programin për shkencat natyrore (aspektin kognitiv-intelektualë, social dhe psikomotorik). *Listat e evoluimit në mënyrë primare kanë të bëjnë me qëllimet të cilat tërësisht arrihen në nivelin e klasës së tretë dhe nuk janë të kalueshme për klasë më të lartë.*

VLERËSIMI MIKROSUMATIV- Në fund të tremujorit të dytë në bazë të njohurive të vlerësimit formativ, realizohet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV- Në bazë të dhënave të përgjithshme të fituara nga ndjekja e vlerësimit formativ mësuesi konstaton (përkthyer gjendjen zhvillimore të secilit nxënës veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore.

ARITSHMËRIA DHE KALUESHMËRIA E PËRMBLEDHJES SË DËSHMIVE

- Përmbledhja e dëshmive duhet që gjatë tërë vitit shkollorë të jetë transparente për prindërit me qëllim që të mund të kontribuojnë në realizimin cilësor të mësimit të shkencave natyrore.
- Nota përfundimtare analitike- përshkruese u ofrohet, gjithashtu prindërve dhe bëhet pjesë e përmbledhjes së dëshmive të nxënësit.
- Përmbledhja e dëshmive të nxënësit me të dhëna të pastruara dhe klasifikuara vazhdon në klasën (më të lartë) e ardhshme.

MËNYRA E KONTROLLIMIT DHE VLERËSIMIT – Në pajtim me natyrën e programit për shkenca natyrore në klasën e tretë, kontrollimi dhe vlerësimi përshkrues duhet të realizohet *në mënyrë gojore, praktike, përmes prezantimit dhe ushtrimeve e aktiviteteve përkatëse.*

3. Kushtet hapësinore për realizimin e programit

Programi lidhur me kushtet hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë për klasën I,II dhe III dhe në mjetet mësimore për klasën e III të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Normativ për kuadrin mësimor

Mësimin e lëndës shkencat natyrore në klasën e tretë mund ta realizojë:

- profesor për mësim klasor;
- pedagog i diplomuar.

Nënshkrimi dhe data e miratimit të programit mësimor

-Programi mësimor për *shkenca natyrore* në klasën e tretë nëntëvjeçare, i marrë me leje të Qendrës ndërkombëtare për programe mësimore (Cambridge International Examination) dhe i adaptuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit, e miraton

me datë

Ministër

Spiro Ristovski